



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.339/2020

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Enver Peci, kryetar, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit D.S., për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale nga neni 234 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë PA1.nr.446/2020 të datës 17.08.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23 dhjetor 2020, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e prokurorit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë PA1.nr.446/2020 të datës 17.08.2020.

### A r s y e t i m

#### **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Novobërdë, me aktgjykimin P.nr.62/2018 të datës 27.01.2020, ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe e ka shpallur fajtor të dënuarin D.S. për veprën penale keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale nga neni 234 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në lartësi

prej 3400 (tremijë e katërqind) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 28.09.2017 deri me datë 08.02.2018. I dënuari është obliguar në pagesën prej 30 € në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 30€, në fondin e kompensimit të viktimave të krimit.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.446/2020 të datës 17.08.2020, ka hudhur si të palejuar ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të konstatohet se aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit pretendohet se aktvendimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 381 par.3 të KPPK-së. Theksohet fakti se për këtë çështje penale procedura është zhvilluar për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale nga neni 234 par.1 të KPRK-së, e cila vepër bën pjesë në kapitullin e XX-të të KPRK-së, përkatësisht te veprat penale kundër integritetit seksual.

Pretendohet se gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 381 par.3 të KPPK-së dhe në këtë mënyrë është shkelur e drejta e palës së dëmtuar për të vendosur sipas ankesës së saj, pasi që dispozita në fjalë në mënyrë të qartë përcakton të drejtën e palës së dëmtuar për të paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me sanksionin penal për veprat penale kundër integritetit seksual.

Më tutje pretendohet se i dëmtuari përkatësisht përfaqësuesi i saj ankesën e ka parashtruar për shkak të sanksionit penal duke kundërshtuar dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë meqë dënimi i shqiptuar nuk do të arrinte qëllimin ndëshkimor përkatësisht duke kërkuar shqiptimin e dënimit me burgim më të rëndë, prandaj me këtë rast janë shkelur dispozitat e procedurës penale kur është konstatuar se ankesa është e paraqitur nga personi pa të drejtë ankese.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i prokurorit të shtetit është i pabazuar, ngase aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, nuk përmban shkelje të pretenduara. Në rastin konkret nuk është i bazuar pretendimi, siç është theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë janë shkelur dispozitat esenciale të procedurës penale përkatësisht neni 432 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 381 par.3 të KPPK-së, pasi që gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj ka dhënë arsyetim të qartë përkitazi me arsyen se ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar e ka hudhur si të palejuar, duke theksuar faktin se në rastin konkret bazuar në dispozitën e nenit 233 par.13 të KPPK-së, ankesa lejohet vetëm në rastet kur vendimi mbi dënimin tejkalon kufijtë e përcaktuar të dënimit me marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimin e theksuar, konstatoi faktin se në rastin konkret bëhet fjalë për vepër penale të përcaktuar në kapitullin e XX-të përkatësisht vepër penale kundër integritetit seksual dhe në parim në këto raste i dëmtuari ka të drejtë të paraqes ankesë vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionin penal, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 381 par.3 të KPPK-së. Mirëpo me dispozitën e nenit 233 të KPPK-së që rregullon procedurën e negociimit të marrëveshjes së pranimin të fajësisë që është procedurë

specifike nuk ka paraparë këtë të drejtë të palës së dëmtuar, andaj duke marrë parasysh faktin se dispozitat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë paraqesin lege specialis në raport me dispozitat e përgjithshme, atëherë në rastin konkret nuk lejohet paraqitja e ankesës nga ana e palës së dëmtuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.339/2020, më 23 dhjetor 2020

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Enver Peci